




Planuar / Doretuar Puniljeno/Prototato Received/Delivered		30.04	2021	1	viti god year
Organ /Mesta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix		Sasia Kohema Quantity	
SKPMST/CK	2160/2021			112	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.180/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e datës 24.03.2021 me numër A.nr.180/2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Rruga "Ndue Perlleshi", ndërtesa Pozhegu BD Lagjja "Mat1", kati 5 nr.33, në Komunë të Prishtinës, kundër Vendimit me Nr.303-2 të datës 25.02.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MAP-Qeveria e Republikës së Kosovës, organit të punësimit Ministria e Financave, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.180/2021 të datës 24.03.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i sistemuar në pozitë Analist i lartë IT-së, në Departamentin për Menaxhimin e Shërbimeve të Teknologjisë Informative, në Ministrinë e Financave, kundër Vendimit me Nr.303-2 të datës 25.02.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në MAP-Qeveria e Republikës së Kosovës, ka parashtruar ankesë me data 24.03.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokolli 1357/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.03.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Financave.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1357/2021 të datës 24.03.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me Nr.303-2 të datës 25.02.2021 i Departamentit për Menaxhimin e

Zyrtarëve Publik në MAP-Qeveria e Republikës së Kosovës; Shkresë nga Ministria e Shëndetësisë e datës 24.03.2021; Marrëveshje e datës 30.09.2019; Aneks i datës 13.08.2019; Marrëveshje e re e bursës së Qeverisë e datës 30.09.2019; rekomandim i datës 01.08.2020; E-mail 24.11.2020; lista e pozitive ne shërbimin civil sipas katalogut të punës; E-mail 25.11.2020; E-mail 02.12.2020; E-mail 27.11.2020; Raport mjekësor i datës 12.04.2020, i datës 04.12.2020; Certifikatë shëndetësore e datës 07.12.2020; E-mail 13.03.2021; E-mail 27.06.2020 nga ½ faqe; E-mail 30.11.2020; E-mail 25.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit **është bërë i pamundur, sepse.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datë 24.03.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, me numër protokolluar 1357/2021, ndërsa më datë 30.04.2021 ka parashtruar kërkesë me numrin e protokollit 2140/2021 për tërheqjen e ankesës së parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes formës elektronike E-maili të ankesave dhe tek zyrtarja e lartë për bashkëpunim profesional.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka analizuar tërheqjen e ankueses ka konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e ankuesit, e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, në këtë rast Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.180/2021, datë 30.04.2021.

Zylë Millaku GOJNOVCI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Financave dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së

